



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:169460

Datë: 28.10.2022

Numri i dokumentit: 03583984

**PKR. Nr. 156/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Krimeve të Rënda**, me Kryetarin e trupit gjykues, gjyqtarin Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taranish, në çështjen penale kundër të akuzuarit T. GJ. nga fsh. ., K. Klinë, për shkak të veprave penale, **“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par.1, dhe veprës penale **“Posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope apo analoge”** nga neni 269 par. 1, të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, **PP/I. 86/22** të datës **24.08.2022**, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë **17.10.2022**, në prezencë të Prokurores së shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të akuzuarit T. GJ. dhe mbrojtësit të tij, av. Prenk Palushi, sipas detyrës zyrtare, me dt. 20.10.2022, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 28.10.2022, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

***I akuzuari:***

**T. GJ.**, i biri i K., dhe nënës J. e gjinisë K., i lindur me datën , në fsh. D. K. K. ku dhe banon në rr. B.F. nr. ..., i identifikuar me nr. personal ..., posedon telefon me numër .../...-..., me profesion kamarier , i gjendjes to të mire ekonomike, i pa martuar, ka te kryer shkollën e mesme elektrikist, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë i ndaluar në kohëzgjatje prej 48 orëve sipas aktvendimit RLN 17/22 dt. 24.02.2022, tani gjendet në liri,

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

I. Me parë e gjerë me dt.24.02.2022, rreth orës 17:50 në rr” A. R. “ ne Klinë, i pandehuri në kundërshtim me nenin 22 par. 2 dhe 3 të Ligjit për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll dhe atë: një pistoletë e tipit Z. prodhim J. me nr. serik ET-....., kalibër 6.35 dhe 1 karikator, në atë mënyrë që ditën kritike gjersa policia e Kosovës gjatë bastisjes dhe kontrollit në lokalin shisha C. B. SH.P.K, te pandehurit i gjejnë dhe sekuestrojnë armën e cekur si më lart.

- me çka ka kryer veprë penale, **“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par. 1, të KPRK-së.

II. Më dt. 24.02.2022, rreth orës 17:50, në rr” A. R. “ ne Klinë, pa autorizim ka poseduar substanca narkotike te llojit marihuan dhe kokainë, në atë mënyrë që ditën kritike gjersa policia e Kosovës gjatë bastisjes dhe kontrollit në lokalit shisha C. B.SH.P.K, në kuzhinën e lokalit policia gjejnë dhe sekuestrojnë një sasi te substancës narkotike të ndare ne 7 pjesë te vogla te futura ne qese te cilat pas ekzaminimit kane rezultuar te llojit kokainë në sasi te përgjithshme prej ...gr, si dhe . qese te najlonit te mbushur me substance narkotike, te cilat pas ekzaminimit kanë rezultuar te llojit marihuan ne sasi te përgjithshme prej ...gr.

-me çka ka kryer veprë penale, posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par. 1, të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 8 par. 1, 9, 10 par. 1, 17 par. 1, 21 par. 1 dhe 2, 38, 39, par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, dhe 366 par. 1 dhe par. 3 dhe 269 par. 1 dhe par. 3 të KPRK-së, dhe nenit 245, 246, 248 par. 1 dhe 4, 359, 360, 361, 365, 366, 453 par. 4 te KPPRK-së, të pandehurin T. GJ. e:

### **G J Y K O N**

- I. Për veprën penale nga dispozitivi I të këtij Aktgjykimi, me dënim me gjobë në shumë prej gjashtëqind (600) euro e të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguaje në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prere.
- II. Për veprën penale nga dispozitivi II të këtij Aktgjykimi, me dënim me gjobë në shume prej pesëqind (500) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, e të cilat dënime fare nuk kanë për tu ekzekutuar nëse i pandehuri në afat prej dy (2) vitesh nuk kryen veprë tjetër penale.
- III. Në dënimin e shqiptuar si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, konform nenit 79 par. 1, të KPRK-së, i llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim policor në kohëzgjatje prej 48 orëve dhe atë nga dt. 24.02.2022.
- IV. Nëse i pandehuri, refuzon, dështon apo nuk paguan dënimin e shqiptuar me gjobë si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i njëjti do to zëvendësohet ne dënim burgimi duke i llogaritur një (1) ditë burgimi në shumen prej 20 (njëzetë) euro.
- V. Nëse i pandehuri kryen veprë tjetër penale, dënimi i kushtëzuar me burgim dhe me gjobë nga pika II të këtij dispozitivi, respektivisht dënimi me kusht prej 1 (një) viti dhe dënimi me gjobë në shume prej pesëqind (500) euro do të revokohen dhe do të ekzekutohen.
- VI. Konform nenit 453 par. 4 të KPPRK-së, i pandehuri lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale, pasi që sipas kartelës e ndihmës sociale, është shfrytëzues i ndihmës sociale.
- VII. Ndaj të pandehurit T. GJ. i shqiptohet:

### **DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI**

Konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së, **KONFISKOHET** një (1) pistoletë e tipit Z., prodhim J. me nr. serik ..-....., kalibër ... dhe një (1) karikator dhe te njëjtat **URDHËROHET**, të shkatërrohen pasi qe Aktgjykimi të behët i plotfuqishëm.

Konform nenit 269 par. 3 të KPRK-së, **KONFISKOHEN** substancat narkotike dhe atë të llojit kokain me sasi të përgjithshme prej .. gram, dhe të llojit marihuanë me sasi të përgjithshme prej .... gram, dhe të njëjtat **URDHËROHET** që të shkatërrohen pasi qe Aktgjykimi të behët i plotfuqishëm.

### Arsvetim

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën nën shenjen **PP/I Nr. 86/22** të datës **24.08.2022**, kundër të akuzuarit, T. GJ. nga fsh. D., K. Klinë, për shkak të veprave penale, **“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par.1, dhe veprës penale, **“Posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope apo analoge”** nga neni 269 par. 1, të KPRK-së

Gjykata me dt. 17.10.2022, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale, në të cilën kanë marrë pjese Prokurorja e Shtetit, Valbona Disha Haxhosaj, i pandehuri T. GJ. dhe mbrojtësi i tij, Av. Prenk Palushi, sipas autorizimit.

Pas leximit të aktakuzës, nga ana e Prokurorit të shtetit, nën shenjen **PP/I Nr. 86/22** të datës **24.08.2022**, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata, ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë, kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e **pranon fajësinë**, për veprat penale, **“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par.1, dhe veprës penale, **“Posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope apo analoge”**, nga neni 269 par. 1, të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim, i vjen keq për veprimin e bërë.

Prokurorja e Shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë, nga ana e të pandehurit T. GJ., ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë, meqenëse ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe i propozoj gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovon.*

Mbrojtësi i të pandehurit në lidhje me pranimin e fajësisë, nga ana e të pandehurit T. GJ. ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë, nga ana e të mbrojturit tim pasi që pranimi i fajësisë, është bërë në mënyrë vullnetare, pa ndikim pa ndërhyrje të askujt, pas konsultave me mua si mbrojtës, dhe i propozoj gjykatës që ta aprovon pranimin e fajësisë.*

Në vijim, gjykata duke shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje te lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata me Aktvendim procedural, e ka aprovuar pranimin e fajësisë, për veprat qe i vihen në barrë, nga ana e të akuzuarit ngase pranimi i fajësisë gjen

mbështetje edhe në provat vijuese: raporti i oficerit B. G. me nr. te rastit 2022-/-... e dt.24.02.2022; shënim zyrtar i dt.24.02.2022; vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve e dt. 24.02.2022; raporti i analizës se narkotikeve me nr. te rastit ...-/-...; raporti për bastisje e dt. 24.02.2022; foto albumi i vendit te ngjarjes; raporti i policit D. D. me nr. te rastit 2022-/-... e dt. 24.02.2022; shënim zyrtar me nr. te rastit 2022-/-... e dt. 24.02.2022; vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm te sendeve (pistoletës) dt. 24.02.2022; raporti i ekspertimit me nr. AKF/2022-..../2022-.... e dt. 15.06.2022 (ekzaminimi daktiloskopik); Raport i Ekspertimit me nr. AKF/2022-..../2022-.... e dt. 12.07.2022 (substancia narkotike kokainë),raporti mbi ekzaminimin e telefonit te dt. 15.08.2022, si dhe shkresat e tjera te lëndës, dhe mbi këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë, se i akuzuari ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë dhe për këtë është vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4, të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Prokurori i Shtetit në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *meqenëse i akuzuari e pranoi fajësinë unë ne tërësi mbes pranë përshkrimit faktik dhe juridik të veprave penale dhe i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënon sipas ligjit si dhe ta obligoje ne paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, dhe i propozoj gjykatës që substancia narkotike dhe arma të cilat kane qene objekt i veprave penale dhe për të njëjtat të lëshohet urdhri për shkatërrim. Me rastin e marrjes se vendimit mbi dënimin i propozoj gjykatës që si rrethana lehtësuese ta merr pranimin e fajësisë kurse rrethana renduese ne rastin konkret nuk kam gjetur.*

Mbrojtësi i të pandehurit në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *dispozitat ligjore nenit 269 e KPRK-së për veprën penale në fjale nuk e përjashtojnë përgjegjësinë penale, ne baze të të cilave dispozitave figura e veprës penale konsiderohet e konsumuar edhe me veprimet inkriminuese të të pandehurit, mirëpo përdorimi i substancave psikotropike dhe analoge si dhe konsumimi i tyre ne krahasimin me kultivimin, prodhimin, shpërndarjen apo shitjen paraqet rrethane lehtësuese, sikurse që në rastin konkret rrethana lehtësuese është edhe pranimi i fajësisë, fakti që për të here të pare ka ra ndesh me ligjin, pendimi për veprën e kryer penale, premtimi që në të ardhmen nuk do të përsëris veprën e njëjte penale si dhe mosha e re e të pandehurit, për të cilat mendoj që duhet të ketë ne konsideratë gjykata ashtu edhe prokuroria me rastin e marrjes se vendimit lidhur me vendosjen apo jo të ushtrimit të mjetit juridik, prandaj propozoj që në rastin konkret mbrojtja penalo juridikë si dhe qëllimi i dënimit mund të arrihet për veprën penale nga neni 366 dënimi me gjobe duke marre parasysh gjendjen ekonomike e vështire, ndërkaq për veprën penale nga neni 269 dënimin alternativ për dy dënime kumulative, krahas gjykatës i dorëzon në lidhje me shpenzimet e procedurës penale një karton i ndihmës sociale në emër të prindit të tij.*

I pandehuri T. Gj. ka deklaruar së: *e mbështes deklarimin e mbrojtësit tim, nuk kam çka të shtoj më shume, i premtoj gjykatës që nuk do ta përsëris veprimet e tilla, me vjen keq që ka ndodhur, është hera be parë që kam ra ndesh me ligjin.*

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv I dhe II te këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale **“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të**

***paautorizuar të armëve***”, nga neni 366 par.1, dhe veprës penale ***“Posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope apo analoge”*** nga neni 269 par. 1, të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprat penale ta kryeje në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv I dhe II të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprat e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e tyre.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Kryetari i trupit gjykues në aplikim të neneve 69 dhe neni 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara e të përmendura nga ana e Prokurorit të Shtetit gjatë seancës të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë të vullnetshme, po ashtu pendimin e tij për veprën e kryer, sjelljen e tij korrekte gjatë seancës, mosdenueshmerine e tij të mëparshme, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsëris veprimet e tilla, moshën e tij të rë, ndërkaq nga rrethanat rënduese gjykata në rastin konkret për të pandehurin e lartcekur nuk gjeti asgjë.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit për veprën penale, ***“Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm”***, nga neni 367 par. 1, të KPRK-së, ka aplikuar dispozitat të cilat kanë të bëjnë me zbutjen e dënimit, e krejt kjo duke pasur parasysh rrethanat veçanërisht lehtësuese të cekura si më lartë, ashtu që duke vepruar konform dispozitave ligjore të neni 71 dhe 72 par. 1, nën par. 1.5 të KPRK-së, e ku përcaktohet se, ***“nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim”*** ashtu që gjykata të njëjtit i ka shqiptuar dënimin me burgim nder minimumit të parapare ligjor në aplikim të këtyre dispozitave.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform neni 38 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me gjobë, si ne piken I të dispozitivit, për veprën penale ***“Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”*** nga neni 366 par. 1 të KPRK-së u morr konform neni 43 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit të kushtëzuar me gjobë dhe me burgim për veprën penale ***“Posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope apo analoge”*** nga neni 269 par. 1 të KPRK-së u morr konform neneve 46, 47, 48, 49, 50 të KPRK-së.

Vendimi për llogaritjen e kohës së kaluar në ndalim policor në kohëzgjatje prej 48 orëve u morr në përputhje me nenin 79 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi për zëvendësimin eventual e dënimit të shqiptuar me gjobe me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon apo refuzon ta paguan dënimin me gjobë u morr konform neni 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimin mbi zëvendësimin e dënimit me kusht në dënim burgimi në rast se i pandehuri brenda periudhës së verifikimit kryen veprë tjetër penale u morr në përputhje me nenin 50 par. 1 dhe 2 të KPRK-së.

Vendimi për lirim nga paguarja e shpenzimeve të procedurës penale dhe taksës për kompensimin e viktimave të krimit u morr konform nenit 453 par. 4, të KPRK-së, pasi që i njëjti ka paraqitur kartelën e ndihmës sociale e cila dëshmon se familja e tij, është shfrytëzuese e ndihmës sociale.

Vendimi për konfiskimin e armës e cila ka qenë objekt i veprës penale nga dispozitivi I, u morr konform nenit 366 par. 3 të KPPRK-së

Vendimi për konfiskimin e substancave narkotike të cilat kanë qenë objekt i veprës penale nga dispozitivi II, u morr konform nenit 269 par. 3, të KPPRK-së

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Krimeve të Rënda**  
**PKR.nr.156/22 dt. 28.10.2022**

**Zyrtari ligjor,**  
Alan Taranish

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Dr.sc. Murat Hulaj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.